

Pyetjet e bëra më shpesh në lidhje me thirrjen për propozime

“Lumenj të pastër – Dete të pastër (RiverClean)

EuropeAid/180788/DD/ACT/AL – Kontrata IPA III/2024/459-979”

1. Kush është i/e kualifikuar për të aplikuar sipas kësaj Thirrjeje për Propozime?

Kandidatët e kualifikuar duhet të jenë organizata jofitimprurëse të regjistruara ligjërisht (si OJQ, shoqata, fondacione ose qendra) që janë të themeluara dhe aktive në Shqipëri. Ata duhet të kenë përvojë relevante në mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm ose angazhimin e komunitetit. Aplikantët nuk duhet të jenë subjekte politike ose fetare dhe nuk duhet të kenë ndonjë të dhënë për sjellje mashtruese, korruptive ose joetike.

→ Shih Seksionin 2.1.3 – E drejta e Aplikantëve, faqet 9–10.

2. Cili është objektivi kryesor i kësaj thirrjeje?

Kjo thirrje synon të mbështesë iniciativat e bizneseve të sektorit HoReCa, të udhëhequra nga shoqëria civile që zvogëlojnë plastikën njëpërdorimshe dhe promovojnë alternativa të drejta dhe të qëndrueshme brenda këtij sektorit në pellgjet e lumenjve Ishëm dhe Vjosë. Metodologjia e pritur për të gjitha veprimet e propozuara është Indeksi HAPI.

→ Shih Seksionin 1.3 – Rëndësia për këtë Thirrje për Propozime, faqja 7; dhe Seksionin 1.4 – Objektivat e Programit, faqja 7.

3. Çfarë është Metodologjia HAPI dhe si duhet të zbatohet?

Metodologjia HAPI (Indeksi i Alternativave të Ndershme ndaj Plastikës) është një qasje e strukturuar dhe pjesëmarrëse e përdorur për të vlerësuar dhe zvogëluar përdorimin e plastikës njëpërdorimshe në hotele, restorante dhe kafene (HoReCa). Ajo përbëhet nga katër faza kryesore që mbulojnë: diagnostikimin, planifikimin e veprimit, zbatimin dhe reflektimin/certifikimin. Aplikantët pritët ta ndjekin këtë metodologji gjatë gjithë projektit të tyre.

→ Shih Seksionin 1.2 – Metodologjia HAPI, faqet 4–6.

4. Cili është diapazoni i financimit të disponueshëm për grant?

Aplikantët mund të kërkojnë një minimum prej 12,000 eurosh dhe deri në një maksimum prej 15,000 eurosh. Granti do të mbulojë 100% të kostove të pranueshme të veprimit të propozuar.

→ Shih Seksionin 1.5 – Ndarja financiare nga autoriteti kontraktues, faqja 8.

5. Cila është kohëzgjatja e kërkuar e projektit?

Projekti i propozuar duhet të ketë një periudhë zbatimi jo më pak se 12 muaj dhe jo më shumë se 14 muaj.

→ Shih Seksionin 2.1.3 – Veprime të Pranueshme, faqja 10.

6. Sa aplikime mund të paraqesë një organizatë?

Çdo aplikant ose bashkë-aplikant mund të marrë pjesë vetëm në një aplikim sipas kësaj Thirrjeje. Dorëzimet e shumëfishta do të rezultojnë në skualifikim.

→ Shih Seksionin 2.1.3 – Numri i aplikimeve, faqja 11.

7. Cilat dokumente kërkohen për të paraqitur një aplikim të plotë?

Përveç formularit të aplikimit të plotësuar dhe shtojcave, aplikantët duhet të paraqesin dokumente të regjistrimit ligjor, statutet e organizatës, regjistrimin tatimor (NIPT), pasqyrën financiare të organizatës për vitin e kaluar (të vulosur nga Drejtoria Rajonale e Taksave), një Certifikatë Dëshmi Penaliteti për përfaqësuesin ligjor dhe CV-të e stafit kryesor të projektit.

→ Shih Seksionin 2.2.1 – Dokumentet mbështetëse që duhen dorëzuar, faqja 13; dhe Seksionin 3 – Lista e Dokumenteve, faqja 18.

8. Cilat lloje aktivitesh konsiderohen të pranueshme për financim?

Aktivitetet e pranueshme përfshijnë auditimin e bizneseve HoReCa duke përdorur Indeksin HAPI, fushata ndërgjegjësimi, ndërtimin e kapaciteteve për stafin, promovimin e alternativave ndaj plastikës njëpërdorimëshe dhe bashkëpunimin me institucionet ose shkollat lokale. Aktivitetet duhet të zbatohen brenda baseneve të lumenjve të synuara.

→ Shih Seksionin 2.1.3 – Llojet e veprimeve të pranueshme, faqja 10.

9. Cilat kosto konsiderohen të pranueshme dhe të papranueshme sipas kësaj Thirrjeje?

Kostot e pranueshme duhet të lidhen drejtpërdrejt me projektin, të jenë të kryera gjatë periudhës së zbatimit dhe të dokumentuara siç duhet. Kostot e papranueshme përfshijnë TVSH-në, gjobat, interesat e kredisë dhe kostot e mbuluara tashmë nga burime të tjera.

→ Shih Seksionin 2.1.4 – Cilat kosto lejohen?, faqet 11–12.

10. Cila është procedura e aplikimit?

Aplikimet duhet të dorëzohen si në formë të printuar (një kopje origjinale) ashtu edhe në formë elektronike (në USB ose CD), në një zarf të mbyllur me etiketën “Nuk duhet të hapet para seancës së

hapjes – Thirrja HAPI për Propozime Projektsh”. Paketa e plotë duhet të dorëzohet në Milieukontakt Shqipëri deri më 8 shtator 2025, në orën 16:30.

Adresa e plotë postare është:

Milieukontakt Shqipëri
Kodi Postar 1001
Rruga Xhoxhi Martini, Pallati Teuta Konstruksion
Shkalla 3, Apartamenti 8
Tiranë, Shqipëri

→ Shih Seksionin 2.2.2 – Dorëzimi i aplikimit, faqja 13.

11. Si do të vlerësohen aplikimet?

Vlerësimi përbëhet nga dy faza: (1) kontrolli i përputhshmërisë administrative, dhe (2) vlerësimi cilësor bazuar në një matricë vlerësimi. Vetëm propozimet që marrin të paktën 65 nga 100 pikë do të vijojnë procesin e vlerësimit për përzgjedhje.

→ Shih Seksionin 2.3 – Vlerësimi dhe Përzgjedhja e Aplikimeve, faqet 14–17.

12. Kur do të njoftohen aplikantët për rezultatet?

Aplikantët do të njoftohen për rezultatet deri më 10 tetor 2025. Afati i fundit për të paraqitur çdo ankesë është 17 tetor 2025, dhe kontratat me aplikantët e përzgjedhur pritet të nënshkruhen deri më 3 nëntor 2025.

→ Shih Seksionin 2.4–2.6 – Njoftimi, Ankesat dhe Kalendari Tregues, faqet 17–18.

13. Ku mund të gjenden formularët e aplikimit dhe ku mund të marr më shumë informacion?

Paketa e plotë e aplikimit (Shtojcat A–D dhe L) mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit e Milieukontakt Albania: www.milieukontakt.org.

→ Shihni Seksionin e Njoftimeve, faqja 1.

14. A duhet të hapim një llogari të dedikuar bankare për këtë projekt?

Nuk është detyrim hapja e një numri të dedikuar të llogarise bankare, por mbajtja sipas standardeve të kontabilitetit në Republikën e Shqipërisë.

15. A lejohet pagesa e qerasë së zyrës brenda këtij projekti?

Qiraja si shpenzim duhet të buxhetohet në kategorinë “Zyra e Projektit”. Që të njihet kjo kosto, planifikimi i saj duhet i argumentuar në kolonën e “justifikimit të koston” duke dhene detaje specifike të

përdorimit të hapësirës për qëllime të projektit dhe të përmbushë kriteret e kostove të lejuara të listuara në udhëzuesin për grante dhe sqarimet në shtojcën 2 “Buxheti I Projektit” pika 8.

16. Unë jam individ, a duhet të bashkëpunoj me një organizatë për të përfituar?

Në këtë thirrje nuk lejohet aplikimi si individ. Aplikimi mund të bëhet nga një organizatë jo fitimprurëse.

17 Jemi një organizatë e re, e cila është formalizuar dhe regjistruar në gjykatë në dhjetor të vitit 2024. Ndaj, nuk kemi ende një vit të plotë veprimtarie financiare dhe për rrjedhojë, nuk kemi pasqyra të tilla për të dorëzuar. Duke qenë se kemi filluar përgatitjen e projekt-propozimit, do të donim të qartësonim këtë pikë para se të avancojmë më tej.

Lidhur me pyetjen tuaj mosdorëzimi i pasqyrave financiare të një viti të mëparshëm nuk është shkak për skualifikim që në fazën e parë të vlerësimit administrativ.

Nuk do të skualifikohen në fazën e parë të vlerësimit administrativ organizatat që aktivitetin e tyre e kanë filluar në vitin 2025 dhe nuk kanë “Pasqyra financiare” të viti të fundit.

Për ta vërtetuar këtë, organizata duhet të paraqesi bashkëlidhur me dokumentet e aplikimit një “Vërtetim të statusit aktiv” nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (nga portali e-albania) në të cilin vërtetohet statusi aktiv dhe data e fillimit të aktivitetit.

18 Jemi një OJF pjesë e qarkut Fier, me qendër në Lushnjë, a mund të aplikojmë për thirrjen e fundit “Cleaner rivers - Cleaner seas (RiverClean) për lumin Vjosë?”

Referuar udhëzuesi të thirrjes nuk ndalohen organizatat që janë nga Bashki të tjera që të aplikojnë por Aktivitetet duhet të zhvillohen përgjatë baseneve të Lumit Ishëm dhe Vjosë.